



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2023-016

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Fejzullah Rexhepi bazuar në nenin 4 dhe nenin 9 paragrafi 1.2 dhe 6 të Ligjit nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 7 paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores nr. 05/2019 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 11 korrik 2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET SI E PABAZUAR, ankesa disiplinore e avokatëve B.A., S.K.-S., F.Sh. ushtruar kundër, gjyqtarëve I.B., S.S., dhe S.H., të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

A r s y e t i m

Si Autoritet Kompetent, në bazë të nenit 9, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-057, "Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve", datë 16.06.2023, kemi pranuar një ankesë nga avokatët B.A., S.K.-S., dhe F.Sh.. Ankesa është ushtruar kundër gjyqtarëve I.B., S.S., dhe S.H., të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Palët ankuese, pretendojnë se më datë 22.03.2023, gjyqtari mbikëqyrës i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, I.B., ka dorëzuar një shkresë në dy faqe pa emër, vetëm me nënshkrim në faqen e parë, tutje thuhet se, shkresa iu kishte adresuar vetëm avokates S.K.-S., dhe përmbante vërejtje citoi: *“Kjo është vërejtja e fundit që po iu drejtojmë, në të kundërtën nëse në të ardhmen përballem më situata të tilla, si gjyqtar mbikëqyrës i DHPGJS-së, jam i detyruar të informoj Odën e Avokatëve, për sjelljen tuaj kundër prestigjit të Odës së Avokatëve dhe*

Etikës së tyre”, e që pala këtë, se e perceptoi si kërcënim. Ankesa gjithashtu pretendon se kjo shkresë nuk është sjellë rastësisht nga gjyqtari I.B.. Si provë, ankesa lidh këtë rast me aktvendimin AC-I-21-0471, i cili ka shfuqizuar aktvendimin e Kolegjit të Apelit AC-I-21-0471, duke anuluar pjesërisht Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit AC-I-15-0212.

Parashtruesit e ankesës, pretendojnë se gjyqtari I.B., të drejtën e pronësisë Z.H., ia ka njohur pa procedura të rregullta gjyqësore, dhe se gjyqtari I.B., në cilësinë e kryesuesit si dhe gjyqtarët S.H., dhe S.S., me Aktvendimin AC-I-22-0369-A0001 të dt. 22.09.22, kishin hedhur si të papranueshme kërkesën e parashtruar me datë 30.06.22, me arsyetimin se të njëjtit nuk i kanë përmendur provat e paraqitura nga përfaqësuesit, në këtë rast ekspertizat e grafologjisë.

Gjithashtu, palët pretendojnë se kolegji në kundërshtim me detyrat e tyre zyrtare, ka refuzuar përsëritjen e procedurës dhe ka vendosur për mbylljen e rastit pavarësisht ekspertizave të dorëzuara, lidhur me parcelën nr.**1743**, për të cilën thuhet se është lëshuar Urdhërndalues nga Prokuroria Themelore në Prishtinë e evidentuar si PP.II.4829/22, ndaj Y.H., trashëgimtar i Z.H., për falsifikim të këtyre dokumenteve të vërtetuara nga ekspertiza.

Lidhur me këto pretendime, si Autoritet Kompetent kam kërkuar sqarime nga gjyqtarët e apostrofuat të rastit, të cilët më datë 26.06.2021, kanë dërguar deklaratën e tyre dhe në mënyrë kronologjike kanë shpjeguar rastin.

Në deklaratën e tyre, theksojnë se Z.H., i është njohur e drejta e pronësisë në ngastrat 1740, 1741, 1742, **1743**, 1744, 1745 si dhe 1899, përmes Aktgjykimit C-II-14-0140-C0001, të datës 14 shtator 2015, këtë Aktgjykim e vërtetoi edhe Kolegji i Apelit me shumicë votash i cili refuzoi si të pabazuar ankesën e AKP-së, në këtë rast. Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit AC-I-15-0212-A0001, është dërguar në Gjykatë Kushtetuese nga AKP-ja, për vlerësim të kushtetutshmërisë.

Gjykata Kushtetuese me Aktvendim KI231/19 e konstaton kërkesën e AKP-së, si të papranueshme dhe e refuzon kërkesën për masë të përkohshme. I njëjti aktgjykim, me kërkesë të B.Sh., A.K., Xh.H., R.D., D.M., dhe F.Ll., me ankesë është dërguar në Gjykatë Kushtetuese, kjo e fundit me Aktvendim nr. KI106/21 e konstaton kërkesën e tyre si të papranueshme dhe e refuzon edhe kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme.

Më 2 dhjetor 2010, përmes padisë së paraqitur në DHPGJS, paditësit N. dhe G.S., kanë kërkuar që të vërtetohet e drejta e pronësisë për ngastrën kadastrale **1743**.

Kolegji i Specializuar i DHPGJ-së me Aktvendimin SCC-10-0352, i datës 19 dhjetor 2017 e hedhë poshtë padinë si të papranueshme, lidhur me këtë paditësit paraqesin ankesë në DHPGJS, të cilën më 14 janar 2021, kolegji i Apelit me Aktvendimin AC-I-18-0026 e refuzon si të pabazuar. Paditësit këtë aktvendim me ankesë e kanë dërguar në Gjykatë Kushtetuese, ndërsa kjo e fundit me Aktvendim për Papranueshmëri KI98/21, e deklaroi kërkesën si të papranueshme.

Më 8 prill 2021, DHPGJS ka pranuar parashtresë nga B.Sh., A.K., e të tjerë për korrigjim të aktgjykimeve C-II-14-0140-C0001 dhe AC-I-15-0212, si dhe parashtresë nga N. dhe G.S., për marrjen e cilësisë së ndërhyrësve në procedurë, këto parashtresa kanë marr numrin AC-I-21-0471.

Lidhur me parashtresat, Kolegji i Apelit me Aktvendim AC-I-21-0471, ndër të tjera, ka vendosur të shfuqizoj aktvendimin AC-I-21-0471 të datës 4 nëntor 2021, propozimin për përsëritje të procedurës dhe caktimin e masës së sigurisë për aktgjykimet C-II-14-0140-C0001 dhe AC-I-15-0212, të aprovoj si të bazuar, të anuloj pjesërisht aktgjykimet C-II-14-0140-C0001 dhe AC-I-15-0212. Në lidhje me këto aktgjykime, N. dhe G.S., kanë paraqitur parashtresa për korrigjimin e aktgjykimeve si dhe propozimin për përsëritje të procedurës.

Në këtë drejtim, gjyqtarët I.B., S.S., dhe S.H., në deklaratën e tyre tutje kanë thënë se, pohimet e ngritura kanë të bëjnë me vendimmarrjen e Kolegjit të Apelit dhe se mbyllja e lëndës AC-I-23-0136 përmes parashtresës ka ardhur në rrethana kur për të njëjtën çështje Kolegji i Apelit kishte vendosur me aktgjykim të formës së prerë. Rrjedhimisht, çështja lidhur me ngastrën kadastrale 1743, është çështje e përfunduar me vendim gjyqësor dhe se kolegji ka dhënë arsyetimin e vet në vendimin gjyqësor.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesit e ankesës, deklaratës së gjyqtarëve I.B., S.S., dhe S.H., të datës 26.06.2023, dhe dosjes së lëndës, në rastin konkret konstatoj, se ankesa kryesisht ka të bëjë me vendimmarrje të gjyqtarëve dhe pakënaqësinë e parashtruesve me vendosje.

Pretendimi i palëve se kolegji duhet të kishte marrë parasysh ekspertizën nuk janë të mbështetura, pasi mendimi i ekspertit ose ekspertiza nuk është e detyrueshme për gjykatën. Gjykata vlerëson ekspertizat sipas rregullave të përgjithshme të parapara për vlerësimin e provave. Gjyqtarët kanë lirinë dhe kompetencën për të vlerësuar provat, për t'i interpretuar dhe për t'i zbatuar në përputhje me ligjin. Diskrecioni i gjyqtarëve, i jep atyre mundësinë të marrin vendime të pavarura dhe të përshkruajnë rastet sipas rrethanave specifike të secilit rast.

Bazuar në dispozitën e nenit 107 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës thuhet se: *“Gjyqtarët gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe veprimet tjera që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtar“*, në rastin konkret konsideroj se veprimet e gjyqtarëve në raport me lëndën konkrete nuk përbëjnë bazë për dyshim për ndonjë sjellje të mundshme disiplinore .

Tutje, sa i përket pretendimit se dokumenti mbi bazën e të cilit është fituar e drejta pronësore është dokument i falsifikuar, duhet theksuar se për të konstatuar një gjë të tillë, duhet të ketë një aktgjykim të formës së prerë, sipas nenit 3 të Kodit të Procedurës Penale, *“çdo person i dyshuar ose i akuzuar për vepër penale konsiderohet i pafajshëm deri sa të vërtetohet fajësia e tij me një aktgjykim të formës së prerë të gjykatës”*.

Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese, derisa ka hedhur ankesat e paraqitura nga palët e ndryshme me Aktvendimet përkatëse, ka konfirmuar drejtshmërinë e vendimmarrjes së Kolegjit. Sipas kësaj, Gjykata Kushtetuese ka konfirmuar vendimet e Kolegjit dhe ka vlerësuar se nuk ka pasur shkelje të rëndësishme ligjore ose kushtetuese në procesin vendimmarrës.

Pretendimi i ankuesve se në shkresën e datës 22.03.2023, gjyqtari mbikëqyrës i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, I.B., i është drejtuar vetëm njërit nga të autorizuarve, nuk paraqet shkelje, pasi në këtë rast dorëzimi dhe komunikimi është bërë konform nenit 107 par.2, të LPK-së, *“Po që se pala ka më tepër përfaqësues ligjor apo me prokurë, mjafton që shkresa t’i dorëzohet njërit nga ta”*.

Ndërsa pretendimi i ankuesve se në shkresën e datës 22.03.2023, gjyqtari mbikëqyrës i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, I.B., ka përdorur gjuhë kërcënuese ndaj avokates, është i pa bazuar pasi gjyqtari në këtë shkresë vetëm i ka tërhequr vërejtjen për pasojat ligjore, nëse e njëjta vazhdon të keqpërdorë të drejtat e saj. Ushtrimi i mjeteve juridike duhet të bëhet konform me dispozitat ligjore, përsëritja e mjeteve juridike, në rastin konkret të kërkesës për përsëritjen e procedurës, deri sa për të njëjtën është vendosur, për të njëjtat arsye nuk mund të paraqitet kërkesë e re, në mënyrë të pa kufizuar për të njëjtën çështje, andaj edhe parashtrësia e gjyqtarit ka pasur për qëllim informimin, dhe në asnjë rast kërcënimin, dhe në rastin konkret nuk mund të konsiderohet se paraqet shkelje ligjore, apo etike.

Andaj, për shkak se në parashtrësën e palës, nuk potencohet për ndonjë shkelje konkrete të supozuar disiplinore të parapara në nenin 5 të ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore

të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kryetar i Gjykatës Supreme

Fejzullah Rexhepi

Kopje:

1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
2. Palëve
3. Gjyqtarëve të Dhomës së Posaçme,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.